



Prishtinë, 28 janar 2016
Kodi i ZRRE-së: V_760_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 14, neni 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës Nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, për HC Shtërpce me kapacitet prej 2.47 MW, HC Bitinja 2.1 MW, HC Vica 2.5 MW dhe HC Brod me kapacitet prej 2.5 MW, në total prej 9.57 MW, në Komunën e Shtërpcës, të datës 29.03.2013 të shoqërisë "Matkos Group" sh.p.k., me adresë "Veternik", KK Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Vendimin nr. V-541-2013 dt. 28 qershor 2013 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "Matkos Group" sh.p.k. për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HC Shtërpce me kapacitet prej 2.47 MW, HC Bitinja 2.1 MW dhe HC Vica 2.5 MW, në total prej **7.07 MW**, në komunën e Shtërpcës.
- Vendimi V-689-2015 i datës 20 shkurt 2015 për Pranim në Skemën Mbështetëse;
- Kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit V-541-2013 dt. 28 qershor 2015 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për HC Shtërpce, Komuna e Shtërpcës, për kompletimin e aplikacionin për marrjen e Autorizimit final;
- Vendimin V-744-2015 të datës 16 korrik 2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-541-2013 dt. 28 qershor 2013, edhe për gjashtë (6) muaj, gjegjësisht deri me 28 dhjetor 2015;
- Kërkesën/aplikacionin për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, Komuna e Shtërpcës, të datës 12.11.2015 të shoqërisë "Matkos Group" sh.p.k., me adresë "Veternik", KK Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Plotësimet dhe ndryshimet e parametrave të kapacitetit të instaluar nga 2.47 MW në fuqinë totale të instaluar 5.031 MW, sipas vlerësimeve teknike, ekonomike dhe mjedisore të kryera në teren dhe të paraqitura në projektin inxhinjerik; dhe
- Kontratat, lejet, pëlqimet dhe vendimit e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në shtojcën II. të këtij vendimi,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 nxori këtë:



V E N D I M PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI** shoqërisë “**Matkos - Group**” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej **5.031 MW**, në Lumin Lepenc, parcela kadastrave nr. 6922 - 0, certifikata e paluejshmërisë P-72717094-06922-0, në sipërfaqe 865 m², kopja e planit nr.426/2013 ZK Shtërpce, Sipas Lejes Ndërtimore të Lëshuar nga Komuna e Shtërpcës.

A r s y e t i m

- ZRRE me datë 29.03.2013 nga shoqëria “**Matkos - Group**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej katër (4) njësive gjeneruese; HC Shtërpce me kapacitet prej 2.47 MW, HC Bitinja 2.1 MW, HC Vica 2.5 MW dhe HC Brod me kapacitet prej 2.5 MW, në total prej 9.57 MW, në Komunën e Shtërpcës.
- ZRRE pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, me datë 28 qershor 2013 ka Lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_541_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim përcaktohet se shoqëria “**Matkos - Group**” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 24.06.2015 ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit V-541-2013 dt. 28 qershor 2015 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për HC Shtërpce, Komuna e Shtërpcës, për kompletimin e aplikacionin për marrjen e Autorizimit final.
- ZRRE me datë 16.07.2015 ka lëshuar Vendimin V-744-2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-541-2013 dt. 28 qershor 2013, edhe për gjashtë (6) muaj, gjegjësisht deri me 28 dhjetor 2015, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 12.11.2015 nga shoqëria “**Matkos - Group**” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej **5.031 MW**, në Lumin Lepenc, parcela kadastrave nr. 6922 - 0, certifikata e paluejshmërisë P-72717094-06922-0, në sipërfaqe 865 m², kopja e planit nr.426/2013 ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.





- ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Autorizim i lëshohet shoqërisë “Matkos - Group” sh.p.k., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar, nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bashkangjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar,


Arsim Janova, anëtar,


Qemajl Mustafa anëtar,


Besim Sejfiqaj anëtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtërpcës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



SHTOJCA I

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja, shoqërisë “Matkos - Group” sh.p.k., me adresë “Veternik”, KK Prishtinë, Republika e Kosovës, me datë **28 janar 2016**, i lëshon këtë:

AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej **5.031 MW**, në Lumin Lepenc, parcela kadastrave nr. **6922 - 0**, certifikata e paluejshmërisë **P-72717094-06922-0**, në sipërfaqe **865 m²**, kopja e planit nr. **426/2013 ZK Shtërpce**, Komuna e Shtërpcës.
2. Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria “Matkos - Group” sh.p.k., që të ndërtojë kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
3. Ky Autorizim do të lëshohet për dy (2) vite, duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE, me kërkesë të palës, mund ta vazhdojë vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - 5.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim,
 - 5.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Kosovë, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat e nenit 19 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
6. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të Autorizuara duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
7. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundojë me skadimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin nën II. të këtij Vendimi, apo me skadimin e afatit tjetër të përcaktuara nga ZRRE në përputhje me pikën 3 të shtojcës I të këtij Autorizimi.
8. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjëres prej kushteve të këtij Autorizimi, të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE mund ta pezullojë këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar gjenerues do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit, ndaj palës së Autorizuar, mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.
9. Pala e autorizuar duhet ta njoftojë me shkrim ZRRE-në, dhe të kërkojë pëlqimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në projektin që është pjesë e aplikacionin.



SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.), të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin** të shoqërisë “Matkos – Group” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, për HC Shtërpce me kapacitet total të instaluar prej 5.031 MW, në Lumin Lepenc, parcela kadastrave nr. 6922 - 0, certifikata e paluejshmërisë P-72717094-06922-0, në sipërfaqe 865 m², kopja e planit nr.426/2013 ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës:

- **Pëlqim për Ndërtimin e HC-ve , shoqërisë “Matkos Group” sh.p.k.,** nr. 06/16 – 854 dt. 29.03.2013 KK Shtërpce;
- **Vendim Preliminar për Krijimin e Servitutit Sendor** nr. 02-16-992 dt. 11.04.2013;
- **Kontrata mbi krijimin e Servitutit Sendor për vendosjen e stabilimenteve** - e lidhur mes Komunës së Shtërpçës dhe shoqërisë “Matkos – Group” sh.p.k. për shfrytëzimin e parcelave Komunale sipas parcelave kadastrale të cekura në kontratë.
- **Vendimi për Pëlqimin Mjedisor** - nr. 14/3721/1-337/DMM e datës 09.09.2014 lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Vendim për Pëlqim Ujor** - nr. 5810-2/14 –ZSP-1384/2015, të datës 02.11.2015, për shoqërinë “Matkos - Group” sh.p.k., për HC Shtërpce, me kapacitetit instalues 5.031 MW në pjesën e sipërme të Lumit Lepenc, Komuna e Shtërpçës, lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Përhershëm (ZSP);
- **Para-marrëveshja për ndërtim të HC Shtërpce,** e lidhur me datë 02.11.2015 mes shoqërisë “Matkos –Group” sh.p.k. dhe GBS KOSOVO CORPORATION JSC. Për realizimin e punëve ndërtimore.
- **Oferta nr. 101320 për Turbina Pelton** - lëshuar nga GEPPERT Hidropower Austria e dt. 03.10.2014.
- **Pëlqimi Elektroenergjetik** - HC Shtërpce, lëshuar nga KEDS nr. 5176 dt. 30.06.2015.
- **Leja Ndërtimore** – nr. 351-6482 e datës 29.07.2015 për ndërtimin e objektit me karakter industrial, për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, në Lumin Lepenc, parcela kadastrave nr. 6922 - 0, certifikata e paluejshmërisë P-72717094-06922-0, në sipërfaqe 865 m², kopja e planit nr.426/2013 ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës.
- **Dokumentacioni tekniko-** investiv HC Shtërpce(për Pëlqim Ujor).
- **Projekti i zhvillimit Hidroenergjetik** (Plani i Vendosjes së HC Shtërpce),

(Vulosur me vulën e rëndomtur të ZPRE-së më):

(Nënshkrimi (në emër të Bordit të ZPRE-së)